

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, në trupin gjykues, të përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i trupit gjykues, Naser Maliqi dhe Sabedin Mushica, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Fikrete Destani, në çështjen penale ndaj të akuzuarit S. V., nga ..., të cilin sipas autorizimit e mbron avokati H. A., nga ..., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,¹ sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.235/2016, e datës 27 shtator 2016, të cilën e përfaqësonte prokurori Agron Uka, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 9 nëntor 2016, mori dhe publikisht shpalli, kurse, më datën 23 nëntor 2016 e përpilojë me shkrim këtë :

AKTGJYKIM

I akuzuari S. V., nga babai M. dhe e ëma H., e lindur A., i lindur më ...në fshatin R., Komuna e B., me vendbanim në Gj., lagjja "...", p.n., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe i Republikës së Sërbisë, i martuar, prind i ... fëmijëve, punëtor, ka të kryer shkollën ..., i gjendjes së varfër ekonomike, më parë nuk ka qenë i dënuar për vepra tjera penale,

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datën ... 2016 rreth orës ..., në rrugën "...” në Gj., i akuzuari pa autorizim ka transportuar-bartur substancë narkotike të llojit "...”, në atë mënyrë që me veturën e tij të markës "...”, me targa regjistrimit ..., nga F. K. është nisur që t’i transportoj-bartë ... paketime të mbështjellura me foli plastike me peshë prej ... kg., të vendosura në pjesën e përparme të automjetit nën haubë – kapakun që mbulon motorrin e automjetit, ashtu që gjatë transportimit të substancës narkotike prej F. K. në Gj., me qëllim destinimit në B. e B., krejt kjo me qëllim transportimi apo dërgimi që nga ky transport të përfitoj shumë prej ... € , ashtu që nga zyrtarët Policor DHTNJ në Gjilan gjatë kontrollimit është konstatuar tek i

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPRK), nr.04/L-082, i datës 20 prill 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

njejtj sasia e substancës narktoike, e cila është gjetur në automjetin e të akuzuarit, si dhe me rastin e testit fushor të substancës narkotike e njejtja është konstatuar se është e llojit "...", me ç'rast vetura dhe substanca narkotike sekuestrohen, ndërsa i akuzuari arrestohet,

-me këtë ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge, nga neni 273 paragrafi 2 të KPRK.

Andaj, trupi gjykues në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 45, 46, 69, 73, 74 dhe 83 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale,² të akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME BURGIM DHE DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të akuzuarit S. V., i caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetëve dhe dënimi me gjobë në shumë prej 2000 € (dymijë Euro), të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i akuzuari refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të akuzuarit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzetë Euro) të dënimit me gjobë do të caktohet nga 1 (një) ditë burgim.

Ndaj të akuzuarit S. V., vazhdohet paraburgimi derisa ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetëve, duke e llogaritur këtu nga dita e arrestimit të tij më datën 13 shtator 2016.

Në dënimin e shqiptuar me burgim, të akuzuarit S. V., do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës ... shtator 2016 e deri sa ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, ashtu që 1 (një) ditë e qëndrimit në paraburgim do të barazohet me 1 (një) ditë të dënimit me burgim.

Konfiskohen substanca narkotike e llojit e llojit "...", në peshë prej ... kg, e ndarë në ...paketime; monedhat ... Euro=... Euro; ...=... Euro dhe ... Euro=... Euro; telefonat "...", ngjyrë e ... me kartelë ..., me numër ...; "...", ngjyrë të ... me ... "..." me numër ...; "..." ngjyrë ..., model i ... me kartelë me numër të Sërbisë, "..." ngjyrë ..., model i ..., me kartelë "...", numër ..., si dhe konfiskohet vetura e markës "...", ngjyrë e ..., me targa të

² Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejshëm KPP), nr.04/L-123, i datës 13 dhejtor 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

regjistrimit ... së bashku me dokumentin e regjistrimit të automjetit numër ... dhe çelsat e veturës.

Detyrohet i akuzuari S. V., që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 50 € (pesëdhjet Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë

ARSYETIMI

1. Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarit S. V., nga ..., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 5 të KPRK.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, të datës 9 nëntor 2016, prokurori Agron Uka, e ka bërë ndryshimin e dispozitivit të aktakuzës, ku është bërë ndryshimi i veprimeve inkriminuese të të akuzuarit, ndërsa, pjesa tjetër e aktakuzës ka mbetur e njëjtë.

Gjatë fjalës përfundimtare, prokurori Agron Uka, i ka propozuar trupit gjykues që i akuzuari S. V., të shpallet fajtor për kryerjen e kësaj vepre penale, sipas aktakuzës së ndryshuar dhe ndaj të akuzuarit të shqiptohet një dënim meritor sipas KPRK.

I akuzuari S. V. dhe mbrojtësi i tij, avokati H. A., gjatë fjalës përfundimtare i kanë propozuar trupit gjykues që ndaj të akuzuarit të shqiptohet një dënim sa më i butë.

2. Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, pas ndryshimeve të bëra në aktakuzë nga ana e prokurorit të shtetit, i akuzuari S. V., ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Trupi gjykues, pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit të të akuzuarit, ka marrë aktvendim për pranimin e fajësisë, ngase ka ardhur në përfundim se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, avokatin H. A.; se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Trupi gjykues, ka konstatuar se i akuzuari S. V., e kishte pranuar fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale edhe gjatë marrjes në pyetje nga ana e zyrtarëve të Policisë së Kosovës, si dhe gjatë marrjes në pyetje në Prokurorinë Themelore në Gjilan.

3. Gjendja faktike e vërtetuar dhe vendimi për shpalljen fajtor të të akuzuarit

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, trupi gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se i akuzuari S. V., me dashje e ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 paragrafi 2 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Si rezultat i kësaj gjendje të vërtetuar faktike, trupi gjykues ka vendosur që ta shpallë fajtor të akuzuarin S. V., për kryerjen e veprës penale të lartcekur, ngase, ka ardhur në përfundim se veprimet e tij i përmbajnë të gjitha elementet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është penalisht përgjegjës. Trupi gjykues, ka konstatuar se nga kualifikimi ligjor i veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari S. V., duhet të hiqet paragrafi 5, për shkak se ky paragraf i nenit 273 të KPRK, i referohet dënimit plotësues – konfiskimit të substancës narkotike dhe konfiskimit të mjeteve për transportimin e tyre. Kështu që, sipas vlerësimit të trupit gjykues, i akuzuari S. V., duhet të shpallet fajtor për shkak të veprës penale nga neni 273 paragrafi 2 të KPRK, pa e ndërlidhur këtu paragrafin 5 të këtij neni.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimeve

Me rastin e shqiptimit të dënimeve ndaj të akuzuarit, trupi gjykues i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 73 dhe 74 të KPRK. Në këtë aspekt, si rrethana lehtësuese, trupi gjykues e ka marrë për bazë pranimin e fëjjesisë nga ana e të akuzuarit S. V., gjë të cilën e kishte bërë gjatë të gjitha fazave të procedurës penale; se sipas deklaratës së të akuzuarit, të cilës trupi gjykues ja ka falur besimin, i akuzuari është i martuar dhe është babë i ... fëmijëve; se i akuzuari është penduar për kryerjen e veprës penale, si dhe faktin se i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Kurse, si rrethanë rënduese, trupi gjykues e ka marrë për bazë faktin se bëhet fjalë për një sasi të madhe të substancës narkotike të llojit "...", në peshë prej ... kg., e cila ishte e ndarë në ... paketime.

5. Shqiptimi i dënimeve në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimeve të shqiptuara

Sipas bindjes së trupit gjykues, dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarit S. V., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit. Me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, trupi gjykues e ka marrë për bazë edhe gjendjen pasurore të të akuzuarit.

Trupi gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6. Zëvendësimi i dënimit me gjobë

Trupi gjykues duke u bazuar në nenin 46 të KPRK, ka vendosur që nëse i akuzuari refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të akuzuarit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzetë Euro) të dënimit me gjobë do të caktohet nga 1 (një) ditë burgim.

7. Vendimi lidhur me paraburgimin

Trupi gjykues, ka vendosur që ndaj të akuzuarit S. V., të vazhdohet paraburgimi derisa ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetëve, duke e llogaritur këtu nga dita e arrestimit të tij më datën ... shtator 2016, ngase ekzistojnë arsyet ligjore për një gjë të tillë, duke u bazuar në nenin 367 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të KPP.

Duke u bazuar në nenin 83 paragrafi 1 dhe 4 të KPRK, trupi gjykues ka vendosur që në dënimin e shqiptuar me burgim, të akuzuarit S. V., do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës ... shtator 2016 e deri sa ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, ashtu që 1 (një) ditë e qëndrimit në paraburgim do të barazohet me 1 (një) ditë të dënimit me burgim.

8. Konfiskimi i substancës narkotike

Duke u bazuar në nenin 273 paragrafi 5 dhe në nenin 69 të KPRK, trupi gjykues ka vendosur që ta konfiskojë substancën narkotike e llojit "...", në peshë prej ... kg, e ndarë në ... paketime; monedhat ... Euro=... Euro; ...=... Euro dhe ... Euro=... Euro; telefonat "...", ngjyrë e ... me kartelë ..., me

numër ...; "...", ngjyrë të ... me kartelë "...", me numër ...; "...", ngjyrë ..., model i ... me ... me numër të Sërbisë, "...", ngjyrë ..., model i ..., me kartelë "...", numër ..., si dhe është vendosur që të konfiskohet vetura e markës "...", ngjyrë e ..., me targa të regjistrimit ... së bashku me dokumentin e regjistrimit të automjetit numër ... dhe çelsat e veturës. Trupi gjykues ka vendosur që të konfiskojë paratë dhe telefonat e lartcekur për shkak se të njejtat janë sende që janë përdorur për të kryer veprën penale dhe që janë dedikuar për të kryer veprën penale, për shkak të natyrës së kësaj vepre penale, ku si rezultat i kësaj edhe e kanë lehtësuar kryerjen e kësaj vepre penale. Gjithashtu, është vendosur edhe që të konfiskohet vetura e markës "...", ngjyrë e ..., me targa të regjistrimit ... së bashku me dokumentin e regjistrimit të automjetit numër ... dhe çelsat e veturës, për shkak se kjo veturë është mjet me të cilën është kryer vepra penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari.

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, trupi gjykues duke u bazuar nenin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar vetëm paushallin gjyqësor në shumë prej 50 € (pesëdhjet Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Krimeve të Rënda

Më 23 nëntor 2016

Sekretarja juridike,
Fikrete Destani

Kryetari i trupit gjykues,
Afrim Shala

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.